



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “THOMA PAPAPANO”, GJIROKASTËR

Nr. 34 prot.

Gjirokastrë, më: 12/02/2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë .

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”; Ligjit **nr. 15/2017**, “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave **nr. 554, datë 31.07.2019**, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; të Udhëzimit **nr. 759, datë 30.9.2024**, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësive të zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit, të udhëzimit **nr. 25, datë 01/09/2023** “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në Ofruesit e Arsimit Profesional”, Shkolla e mesme profesionale “Thoma Papapano” Gjirokastrë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

1. Mësues i teorisë dhe praktikës profesionale, drejtimi « Hoteleri-Turizëm », me kohë të pjesshme.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vendin e lirë si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;
- b) Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
- d) Aftësi të tjera nëse kërkohen

2.Dokumentet e aplikimit:

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) Letërmotivimin për pozicionin;
- b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të udhëzimit **nr.759, datë 30.9.2024**;
- c) Kartën e identitetit;
- d) Diplomën;
- e) Librezën e punës;
- f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) Certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) Vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e SHMP''Thoma Papapano'' Gjirokastrë brenda datës 23.02.2026.

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen enjësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

DREJTOR

Renata Puleri

